



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Numri i lëndës: 2021:148121
Datë: 19.07.2024
Numri i dokumentit: 05960720

KA.nr.811/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtarja Vlora Pacolli-Rexhepi, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit Qendra Klinike Universitare e Kosovës me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenjes Sociale me seli në Prishtinë, me kërkesëpadi për anulimin e vendimit me Nr.877/2021 të datës 01.02.2024, të datës 28.05.2021, konform nenit 13 paragrafi 7 të Ligjit nr. 08/1-015 për Gjykatën Komerciale (LGJK), jashtë seancës, më datë 28.06.2024 merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat Shkalles se Pare - Departamentit për Çështje Administrative shpallet jo kompetente për ta gjykuar këtë çështje administrative
- II. Pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi lënda i dorëzohet Gjykatës Themelore në Prishtinës Departamentit për Çështje Administrative, si gjykatë kompetente për ta gjykuar këtë çështje juridike administrative.

A r s y e t i m

Me datë 08.07.2021 në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Qendra Klinike Universitare e Kosovës me seli në Prishtinë, ka iniciuar konflikt administrativ kundër të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenjes Sociale me seli në Prishtinë, me kërkesëpadi për anulimin e vendimit me Nr.877/2021 të datës 01.02.2024, të datës 28.05.2021. Lenda e evidentuar me nr. A.1552/2021.

Pas funksionalizimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës sipas Ligjit Nr. 08L-015 për Gjykatën Komerciale, lënda është bartur në këtë Gjykatë dhe evidentohet me shifrën KA nr. 81122.

Pas shqyrtimit paraprak të padisë Departamenti për Çështje Administrative pranë Gjykatës Komerciale, gjykata vlerësoj kompetencën lëndore sipas detyrës zyrtare mbështetur në nenin 19 të Ligjit për Procedurën Kontestimore lidhur me nenin 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative vlerëson se nuk është kompetent në pikëpamje lëndore për të gjykuar këtë çështje.

Gjykata vlerësoj se padia në fjalë është parashtruar nga Qendra Klinike Universitare e Kosovës, në cilësi të institucionit shtetëror nën autoritetin e Ministrisë së Shëndetësisë. Gjykata vlerësoj se padia nuk është e iniciuar nga ndonjë shoqëri tregtare, prandaj kjo gjykatë vlerëson se nuk ka kompetencës lëndore për të gjykuar këtë çështje, bazuar në nenet 13, par. 1, nën par. 1.12 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale që përcaktojnë se “1. Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar, dhe ka juridiksion ekskluziv për të gjykuar, në Dhomat e Shkallës së Parë dhe Dhomat e Shkallës së Dytë: kontestet administrative të iniciuara nga shoqëritë tregtare kundër vendimeve përfundimtare në procedurë administrative” lidhur me par. 5 që përcakton se: “5. Të gjitha çështjet e përcaktuara në nën-paragrafin 1.12 të paragrafit 1 të këtij neni do të trajtohen në shkallë të parë nga Departamenti për Çështje Administrative.” Gjithashtu në nenin 3 par. 1, nën par. 1.10 të Ligjit për Gjykatën Komerciale është përcaktuar përkufizimi si në vijim: “Shoqëritë Tregtare – të gjitha shoqëritë tregtare të përcaktuara në Ligjin për Shoqëritë Tregtare”.

Mbështetur në dispozitat e lartcekura, Departamenti për Çështje Administrative pranë Gjykatës Komerciale është kompetent për shqyrtimin e kontesteve administrative të iniciuara vetëm nga shoqëritë tregtare, kundër vendimeve përfundimtare në procedurë administrative.

Në këtë çështje, konflikti administrativ nuk është iniciuar nga ndonjë shoqëri tregtare, por nga një njësi e institucionit shtetëror të shëndetit publik nën autoritetin e pushtetit ekzekutiv, kundër vendimit të administratës shtetërore (OSHP-se), prandaj bazuar në nenin 17 të Ligjit për 06/L-054 për Gjykatat, kompetente për shqyrtimin e kësaj çështje është Departamenti i Përgjithshëm i Gjykatës Themelore në Prishtinë.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr.811/24, datë 28.06.2024

Gjyqtarja

Vlora Pacolli Rexhepi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar e drejta e ankesës, në afat prej 15 ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë të Gjykatën Komerciale në Prishtinë, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.